

NJOFTIM

Për kandidatët që do të vlersohen për pozicionin e punës :

Drejtor i Drejtorise së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit -AKEP

Pozicioni i më sipërm u ofrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se këto pozicione janë ende vakant, ato janë të vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Në rast se një vend vakant, në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore, apo organi kompetent, për institucionet e pavarura, ka marrë vendim, në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, atëherë, në procedurën e ngritjes në detyrë kanë të drejtë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

Procedura : **NGRITJE NË DETYRË**

Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut III të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) njofton se pas vlerësimit paraprak të kandidatëve:

- **Z. Denion Meidani** do të vazhdojnë konkurrimin për pozicionin **Drejtor i Drejtorise së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit**.

Konkurimi

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, Nr.43, në datën **03.04.2018** ora **11:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **03.04.2018** ora **13:30**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë - KPND**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- b. **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **“Drejtor i Drejtorise së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit”**.

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **04.04.2018**.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **05.04.2018**.

Njesia Përgjegjëse

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)